

Shlyerja e Jezu Krishtit më Shëlbon nga ...

Vdekja shpirtërore (ndarja nga prania e Perëndisë)

Mendo për raste kur ke mëkatuar dhe je ndier shpirtërisht larg nga Ati Qjellor. Lexoje sa vijon duke kërkuar mënyrën se si Jezu Krishti mund të të ndihmojë ta kapërcesh këtë ndarje.

Moisiu 5:8, 15

Mormoni 7:7

Plaku Kuentin L. Kuk, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, shpjegoi:



“Për shkak të Shlyerjes së Shpëtimtarit, mëshira mund të triumfojë për ata që janë penduar, dhe mund t’u lejojë të kthehen në praninë e Perëndisë. Do të bënim mirë ta përsiatnim këtë doktrinë të mrekullueshme.

Askush nuk mund të kthehet te Perëndia vetëm nëpërmjet veprave të veta të mira; të gjithëve na nevojitet dobia e flijimit të Shpëtimtarit. Të gjithë kanë mëkatuar dhe vetëm nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit mund të marrim mëshirë dhe të jetojmë me Perëndinë [shihni te 2 Nefi 25:23].” (“Jini të Vërtetë ndaj Perëndisë dhe Veprës së Tij”,

Liahona, nëntor 2022, f. 119)

Vështirësitë ose dobësitë e vdekshmërisë

Mendo për ndonjë vështirësi, sëmundje ose dobësi të vdekshmërisë me të cilën përballesh. Lexoje sa vijon duke kërkuar mënyrën se si Jezu Krishti mund të të ndihmojë gjatë këtyre sfidave.

Alma 7:11–12

Ethëri 12:27

Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim:



“Nuk ka dhembje fizike, as plagë shpirtërore, as ankth të shpirtit apo të zemrës, as dobësi apo lëngatë që ju ose unë do të hasim ndonjëherë në vdekshmëri, të cilën Shpëtimtari nuk e përjetoj fillimisht. ... Ai ka dhembshuri të përsosur dhe mund të na e shtrijë krahun e Tij të mëshirës. Ai mund të na arrijë, prekë, ndihmojë, shërojë e forcojë që të jemi më shumë sesa mund të ishim ndonjëherë dhe që të na ndihmojë të bëjmë atë që nuk mund ta bënim kurrë duke u mbështetur vetëm mbi vetë fuqinë tonë.” (“I Duronin Barrët e Tyre me Lehtësi”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2014, f. 90)


Vdekja fizike

Mendo për njerëz që i njeh, të cilët kanë ndërruar jetë. Imagjino se si do të ishte po të ndaheshe përgjithmonë prej tyre. Lexoje sa vijon duke kërkuar shpresën që mund të përjetojmë për shkak të Shlyerjes së Jezu Krishtit.

1 Korintasve 15:20–22

Mosia 16:7–9

Presidenti Henri B. Ajring, i Presidencës së Parë, dha mësim:



“Çdo ditë bekohehem të di se, për shkak të Shlyerjes së Tij, unë mund të ringjallem një ditë që të jetoj përgjithnjë në një familje të dashur.

I di ato gjëra me anë të së vetmes mënyrë që mund t’i dijë secili prej nesh. Fryma e Shenjtë më ka folur në mendjen dhe zemrën time se ato janë të vërteta – jo thjesht një herë, por shpesh. Kam pasur nevojë për atë ngushëllim të vazhdueshëm. Ne të gjithë përjetojmë tragjedi gjatë së cilës kemi nevojë për t’u siguruar sërish nga Shpirti.” (“Të Keni Shpirtin e Tij me Ju”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2018, f. 86)